



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:030576
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06771026

C-IV-14-3277

Ankuesi

Administrata Tatimore e Kosovës, Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtare Hajrie Shala, me 23 janar 2025, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa REFUZOHET si e pabazuar dhe vendimet e Autoritetit të Likuidimit GJI097-0006 të datës 14 prill 2014 dhe GJI097-0003 të datës 10.04.2014 vërtetohen si të drejtë dhe të bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 prill 2014, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) parashtri ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Dhoma e Posaçme) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) nr. GJI097-0003, të datës 14 prill 2014. Në vendimin e kundërshtuar, **GJI097-0006** kërkesa e ankuesit për pagesën e borxhit tatimor për Tatimin në fitim, në shumë prej 1,404.32 €, për NSH “Tregtia”, në likuidim, është aprovuar pjesërisht për shumën prej 107.29 €, në pajtim me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr.

04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Shtojca e Ligjit të AKP-së), ndërsa është refuzuar për shumën prej 1,297.03 €, si e pabazuar.

Poashtu me vendimin e kundërshtuar **GJI097-0003** kërkesa e ankuesit për pagesën e borxhit tatimor për Tatimin në vlerën e shtuar, në shumë prej 42,231.27 €, për NSH “Tregtia”, në likuidim, është aprovuar pjesërisht për shumën prej 13,841.64 €, në pajtim me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Shtojca e Ligjit të AKP-së), ndërsa është refuzuar për shumën prej 28,389.63€, si e pabazuar me arsyetimin se informatat që janë ofruar ishin të pa mjaftueshme për të mundësuar përfshirjen e saj në qfarëdo shpërndarje të të ardhurave të likuidimit.

Në vendimet e kundërshtuar të datës 10 prill 2014, AKP-ja arsyetoi se sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa mund të përfshijë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës së kërkesës themelore.

Me 02 dhjetor 2024, e paditura AKP-ja, parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu AKP-ja pohoi se neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, bën dallimin mes shumave themelore dhe shumave për tu paguar mbi shumën themelore dhe se ky nen nuk lejon që këto shuma të llogaritura mbi shumën themelore të tejkalojë 10 %.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Bazuar në analizën e të paditurës shuma e pretenduar nga ankuesi në emër të Tatimit në fitim në këtë lëndë ishte 1,905.69 €, nga e cila shuma prej 532.64 € ishte shuma themelore, kurse shuma e ndëshkimeve ishte 1,373.05 €. Në këtë mënyrë shuma totale e aprovuar në emër të Tatimit të pretenduar në fitim ishte shuma themelore prej 532.64 €, duke shtuar shumën prej 53.26 € (10 % ndëshkimet dhe interesi i akumuluar të shumës themelore).

Poashtu bazuar në analizën e të paditurës shuma e pretenduar nga ankuesi në emër të Tatimit mbi vlerën e shtuar në këtë lëndë ishte 35,733.11 € nga e cila, shuma prej 11,628.10 € ishte shuma themelore kurse, shuma e ndëshkimeve ishte 24,105.01 €. Në këtë mënyrë shuma totale

e aprovuar në emër të Tatimit mbi vlerën e shtuar ishte shuma themelore prej 11,628.10 €, duke shtuar shumën prej 1,162.81 € (10 % ndëshkimet dhe interesi i akumuluar të shumës themelore).

Sipas nenit 37.3 të Aneksit të Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit “të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”.

Gjykata konstaton se kjo dispozitë ligjore mbizotëron mbi dispozitat e legjislacionit fiskal të parashtruara nga ankuesi. Procesi ligjor i likuidimit të NSH-ve është një procedurë kolektive ku ligjvënësi ka siguruar që ekziston mundësia që kreditorëve të renditur më ulët në renditjen e përparësisë së pagesave, t’ju paguhet diçka. Neni 37.3 ka rëndësi të madhe për këtë sepse përndryshe do të jetë edhe më e mundshme që të ardhurat nga asetet e likuiduara do të shfrytëzohen nga kërkesat me renditje më të lartë, sipas nenit 40, të cilat do të bëhen më të mëdha përmes akumulimit të kamatës mbi shumën themelore. Neni 37.3 parandalon këtë dhe kufizon shumën e kamatës në 10% të shumës themelore të kërkesës kreditore. Ai vepron me vetëm dy kategori ligjore, e para është shuma themelore e kërkesës kreditore dhe e dyta është kamata për shumën themelore të saj. Atë të cilën ankuesi po përpiqet të bëjë, se ndëshkimet dhe kamata janë dy kategori të ndara dhe të definuara si të tilla në legjislacionin fiskal, nuk është e vlefshme për këtë procedurë sepse, edhe dënimet llogariten lidhur me shumën themelore të kërkesës kreditore, pikërisht si kamata fiskale dhe për shkak të kësaj, ato bien në të njëjtën kategori të dytë të parashikuar nga neni 37.3, të kufizuara në 10 % të shumës themelore.

Kërkesa e tanishme e kreditorit është bërë në procedurat e likuidimit, të rregulluar me Ligjin nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe rrjedhimisht, ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë të Ligjit të Kosovës që nuk është në përputhje me të (neni 31.1). Një zgjidhje tjetër në lidhje me kreditorin fiskal, bazuar në cilësinë e ATK-së si autoriteti i vetëm i autorizuar për mbledhjen e tatimeve në Republikën e Kosovës, do të përbënte diskriminim në mesin e kreditorëve dhe nuk ka ndonjë mbështetje as në nenin 36, ose në cilëndo dispozitë tjetër të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksa gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 8.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala